



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:171268

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05279110

C.nr.414/13

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z. (M) S. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson i autorizuari avokat S.R. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të padisë anulimin e kontratës mbi dhurimin e paluajtshmërisë dhe dorëzimi i paluajtshmërisë, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur me datën 12.10.2023 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET tërësisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Z. (M) S. si trashëgimtar i ish pronarit S.T.M. përmes të cilës ka kërkuar që të **“VËRTETOHET se është absolutisht nule kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë e lidhur ndërmjet S.T.M. ish nga fshati Komuna e Prizrenit si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit, si dhuratëmarrës dhe i vërtetuar me Posl.ov.nr.680/59 të datës 10.09.1959, si dhe VËRTETOHET se paditësi është pronar i palusjtshmërive të regjistruara në bazë të matjes në kadastrë si: 1. Ngastra kadastrale nr.234, në vendin e quajtur “Qepurec” mbi rrugën, sipas kulturës fushore të klasit të V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3727 m² ZK Dushanovë I e cila është në kufirin I masave I dhe në anën lindore kufizohet me me ngastrën kadastrale nr.753/2, në gjatësi prej 58.69 m, nga ana perëndimore kufizohet me parcelën nr.993/6 ZK Landovicë dhe në gjatësi 39.62 m nga ana veriore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.233, në gjatësi 85,37 m dhe në anën jugore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.235 në gjatësi 74,62 m.**

2. ngastra kadastrale nr.236 në vendin e quajtur Qepurec mbi rrugën, sipas kulturës fushore të klasit V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1923 m² e cila e cila nga ana lindore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.753/3, në gjatësi prej 51,66 m, nga ana perëndimore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.235, në gjatësi prej 48,51 m, nga ana perëndimore kufizohet me parcelën nr.235, në gjatësi prej 30,66 m dhe nga ana jugore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.2371, I me ngastrën kadastrale 238 në sipërfaqe prej 31,50 m. Prandaj, Komuna e Prizrenit është e obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të lejoj regjistrimin e sipërfaqeve të lartpërmendura në zyrën e regjistrimit të paluajtshmërive në Prizren nën kërcënim të dhunshëm.”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Z.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, duke theksuar se paraardhësi i paditësit S.T.M. nga fshati Prizren ka qenë pronar i ngastrave kadastrale të evidentuara sipas listës poseduese si ngastra kadastrale nr.II/76, në vendin e quajtur “Dušanovo Čepurec”, me kultur arë në sipërfaqe prej 0.59,00 dhe vreshta në sipërfaqe prej 0.06,00 të cilat janë evidentuar sipas listës poseduese me nr.143 ZK Dushanovë, ndërsa sot në regjistrat kadastral evidentohen në kuadër të ngastrës kadastrale nr.14, me sipërfaqe prej 5240 m2 dhe evidentohen në Zonën Kadastrale Dushanovë. Tutje ka theksuar se pas kërcënimit dhe detyrimit, babai i këtu paditësit ka lidhë kontratën mbi dhurimin e paluajtshmërisë me Komunën e Prizrenit për ngastrat kadastrale të cekura dhe e njëjta kontratë është vërtetuar pranë Gjykatës të Sredskës nën nr. Posl.ov.br.680-59 datës 10.09.1959. Babai i këtu paditësit, si dhe bashkëshortja e tij L.S. kanë vdekur, ndërsa si trashëgimtar është shpallur këtu paditësi. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpapia e paditësit si e bazuar, si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, më gjerësisht si në padi.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësit av. S.R. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë të gjitha deklarimeve gjatë seancave të mëhershme, si dhe pas plotësimit të ekspertizës i njëjti me parashtrësën e datës 15.09.2023 ka bërë precizimin e padisë ashtu që ka heqë dorë nga ngastra kadastrale me nr. 232-0 ZK Dushanovë, në sipërfaqe prej 932 m2. Ndërsa në fjalën përfundimtare e parashtruar me shkrim ka theksuar se, në bazë të shkresave të lëndës konkretisht në kontratën mbi dhuratën e lidhur nga paraardhësi ligjor i paditësit S.T.M. dhe Komunës së Prizrenit dhe i vërtetuar me Posl.ov.br.680/59 e datës 10.08.1859 është konstatuar se vlera dhe lokacioni i paluajtshmërisë që ka qenë objekt i dhuratës në asnjë rast, as atëherë dhe as sot, nuk do të ishte dhënë nga pronari pa asnjë dëmshpërblim, nëse në atë kohë nuk do të ishte ushtruar presion psikologjik dhe fizik ndaj dhënësit. Në rastin konkret ka theksuar se kontrata është lidhur me detyrim ndaj pronarit të atëhershëm dhe anëtarëve të familjes të tij. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpapia e precizuar e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 1460 euro.

Në përgjigjen e tij në padi, përfaqësuesi i të paditurës - Avokati Publik Komunal ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që gjykata ta refuzojë si të pabazuar. Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja ligjore e të paditurës ka ngelur në tërësi pranë deklarimeve në përgjigjen në padi, duke theksuar se, në bazë të provave të administruara në shqyrtim kryesor, paditësi nuk ka arritur të vërtetojë faktin në bazë të pretendimeve në padi, sepse nga provat e parashtruara nuk është provuar se paditësi ka të drejtën pronësie në pronën kontestuese, duke marrë parasysh se provat e paraqitura dhe atë kontrata pos.ov.br.680/59 e datës 10.09.1959 mbi të cilën paditësi pretendon se i takon e drejta në parcelat sipas precizimit të padisë dhe atë parcela kad. 234 dhe 236 , nuk mund të qëndrojnë sepse nga të gjitha provat e administruara në shqyrtim kryesor paditësi nuk ka prezentuar fakte bindëse pse nuk paraqesin ndonjë fakt se kanë parashtruar ndonjëherë ankesë Komunës së Prizrenit lidhur me kontratën në fjalë apo se paraardhësi i tyre S.T.M. të ketë ushtruar ndonjëherë ankesë, dhe nuk dëshmojnë me asnjë fakt lidhur me pretendimet në padi se kjo kontratë është e lidhur me anë të presionit apo kanosjes, si dhe me asnjë provë nuk ka dëshmuar se ka kërkuar revokimin e kontratës apo anulimin e saj brenda afatit ligjor. Po ashtu ka theksuar se papia e paditësit për anulimin e kontratës është në kundërshtim me nenin 111 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 ku sipas kësaj dispozite është përcaktuar qartë afati brenda të cilit lejohet kërkesa për anulimin e kontratës, e që në rastin konkret kanë kaluar mbi 60 vite. Andaj gjykatës i kanë propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit.

Me parashtrësën e datës 15.09.2023 i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që, e ka formuluar padinë dhe kërkesëpadinë lidhur me truallin në bazë të marrëveshjes së dhurimit ku në nenin I tregohet se objekti i Kontratës mbi dhurimin sipas evidencës të ngastrës kadastrale parcela nr. II/76, në sipërfaqe prej 0.59 ha ZK Dushanovë. Në bazë të certifikatës së parë të lëshuar nga kadastri në Prizren ngastrat kadastrale e përmendur sot sipas matjes të kadastrit i përgjigjet ngastrës kadastrale nr.14 ashtu siç është formuluar në kërkesë. Mirëpo gjatë vizitës në terren nga ana e gjeometrit dhe identifikimit në bazë të të dhënave nga raporti kadastral , gjeodeti ka konstatuar se sipërfaqe e tokës të parcelës sipas kadastrës të regjistruar II/76 e cila është objekt i i kërkesëpadisë shtrihet mbi ngastrat kadastrale 232, 234 dhe 236, në vendin e quajtur “Qepurec” mbi rrugën e ZK Dushanovë. Gjithashtu gjatë identifikimit në vend nga ana e ekspertit gjeodet është konstatuar se në vend pjesën e ngastrës nr.232 ka objekt të ndërtuar me kate P+O I në përmasat 12x 8.65 me sipërfaqe totale prej 862 m2 dhe oborr të rrethuar, plus një sipërfaqe prej 70 m2 që përdoret si rrugë / që bënë një sipërfaqe totale të zënë 932 m2. Pasi që komplet sipërfaqja e ngastrës është e zënë me objekt ndërtimi i përhershëm, oborr me mur dhe tokës që shërben për përdorim të rregullt të ndërtesave, si dhe pjesës e truallit rrugor. Andaj i autorizuari i paditësit ka theksuar se në padi I, në kërkesëpadi tërhiqet padinë për ngastrën kadastrale nr.232 në sipërfaqe të përgjithshme prej 932 m2 ZK Dushanovë dhe me kufijtë dhe matjet siç janë dhënë në kopjen e planit nga eksperti gjeodet. Ndërsa sa i përket ngastrës kadastrale nr.234 dhe 236 ZK Dushanovë ato shfrytëzohen si kullota dhe në to nuk ka ndërtime. Andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadija e precizuar e paditësit tërësisht si e bazuar, si dhe të vërtetohet se është absolutisht nule kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë e lidhur ndërmjet S.T.M. ish nga fshati Komuna e Prizrenit si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit, si dhuratëmarrës dhe i vërtetuar me Posl.ov.nr.680/59 të datës 10.09.1959, si dhe vërtetohet se paditësi është pronar i palusjtshmërive të regjistruara në bazë të matjes në kadastrë si: ngastrat kadastrale nr.234, në vendin e quajtur “Qepurec” mbi rrugën, sipas kulturës fushore të klasit të V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3727 m2 ZK Dushanovë I e cila është në kufirin I masave I dhe në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.753/2, në gjatësi prej 58.69 m, nga ana perëndimore kufizohet me parcelën nr.993/6 ZK Landovicë dhe në gjatësi 39.62 m nga ana veriore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.233, në gjatësi 85,37 m dhe në anën jugore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.235 në gjatësi 74,62 m dhe ngastrat kadastrale nr.236 në vendin e quajtur Qepurec mbi rrugën, sipas kulturës fushore të klasit V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1923 m2 e cila e cila nga ana lindore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.753/3, në gjatësi prej 51,66 m, nga ana perëndimore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.235, në gjatësi prej 48,51 m, nga ana perëndimore kufizohet me parcelën nr.235, në gjatësi prej 30,66 m dhe nga ana jugore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.2371, I me ngastrën kadastrale 238 në sipërfaqe prej 31,50 m. Prandaj, Komuna e Prizrenit është e obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të lejoj regjistrimin e sipërfaqeve të lartpërmendura në zyrën e regjistrimit të paluajtshmërive në Prizren nën kërcënim të dhunshëm.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: dëgjimi i dëshmitarit T.Š. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, dëgjimi i dëshmitarit B.Dž. kontrata mbi dhuratë e lidhur me datën 01.01.1959 në mes të Komunës së Prizrenit dhe S.T.M. vërtetuar pranë Sredski Sud u Prizrenu me datën 10.08.1959, certifikata me numër 18-6292 lëshuar me datën 26.03.2013 nga ZKK Prizren, certifikata vdekje për M.S. lëshuar me datën 13.05.2013 nga Zyra e gjendjes civile Lubizhdë, Komuna Prizren, certifikata vdekjes për L.S. lëshuar me datën 13.05.2013 nga zyra e gjendjes civile Lubizhdë, Komuna Prizren, ekstrakti i lindjes për Z.S. lëshuar me datën 10.05.2013 nga Zyra e gjendjes civile në Lubizhdë, Komuna Prizren, aktvdekje për M. (T) S. me numër 200-392 lëshuar me datën 17.07.2014 nga Komuna e Prizrenit, ekspertiza dhe bëhet

shikimi në dy skicat e terrenit punuar nga eksperti gjyqësor i gjeodezisë K.G. nga Prizreni të datës 05.10.2015, skica me numër 7/54 KK Landovicë, parashtresa me të cilën i autorizuari paditësit është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Financa në Prishtinë të datës 22.07.2014, dëgjimi i ekspertit të gjeodezisë K.G. nga Prizreni, raporti plotësues dhe bëhet shikimi në skicën e terrenit gjithsej tre skica, skicën detaje nr. 7/54 të vitit 1954 dhe kopjen e planit punuar nga eksperti gjyqësor K.G. nga Prizreni me datën 31.08.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar.

Dëshmitari T.Š. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, në deklaratën e tij ka theksuar se prona kontestuese është marrë me dhunë nga ana e pushtetit të atëhershëm si dhe shumë prona tjera ku janë kërcënuar pronarët me largim nga puna apo me ndonjë formë tjetër. E gjithë kjo, dëshmitarit i është e njohur, sepse i njëjti është bashkëfshatar me palën paditëse, dhe siç ka cekur ai edhe atij i është marrë toka nga ana e pushtetit të atëhershëm.

Dëshmitari B. (A) Dž. nga fshati Skorobishtë, Komuna e Prizrenit, në deklaratën e tij, ka theksuar se prona kontestuese është marrë me dhunë nga ana e pushtetit të atëhershëm, pasi që ish pronari është kërcënuar me largim nga puna. Të gjitha këto, dëshmitarit i ka të njohura, pasi që i njëjti e ka njohur personalisht M.S. si dhe sa i kujtohet ka biseduar me të njëjtin në korridorin e ndërtesës të Komunës së Prizrenit i cili e ka pyetur se çka me bë, ku dëshmitari i është përgjigjur se, nëse nuk dëshiron me hup vendin e punës atëherë duhet ta shes ose ta dhuroj palujtshmërinë.

Me leximin e kopjes së Kontratës mbi dhurimin e paluajtshmërisë e datës 01.01.1959, të lidhur në mes të S.T.M. ish nga fshati Komuna e Prizrenit dhe Komunës së Prizrenit, gjykata ka vërtetuar se e njëjta është lidhur në mes të tani të ndjerit S.M. ish nga fshati. Komuna e Prizrenit- si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit, si dhuratëmarrës dhe se lëndë e kontratës ka qenë parcela kadastrale nr. II/76, e evidentuar sipas listës poseduese nr.143, ZK Dushanovë.

Nga leximi i Çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme për njësinë kadatsrale P-71813023-.... ZK Dushanovë, gjykata ka konstatuar se paluatshmëria kontestuese në vendin e quajtur “Qatura”, sipas listës poseduese me nr.18-6292, në sipërfaqe prej 5240 m2, evidentohet si pasuri shoqërore- Komuna e Prizrenit.

Nga leximi i certifikatës së vdekjes për M.S. me numër rendor 592, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Lubizhdë me datë 13.05.2013, gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka vdekur me datë 22.10.1991 në Prizren.

Nga leximi i certifikatës së vdekjes për L.S. me numër rendor 1, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Lubizhdë me datë 13.05.2013, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka vdekur me datë 11.08.1975 në fshatin Komuna e Prizrenit.

Nga leximi i certifikatës së lindjes për Z.S. gjykata ka vërtetuar se i njëjti është lindur me datë 08.08.1953 në fshatin Vrbiqane, Komuna e Prizrenit, nga i ati M.S. dhe e ëma L.S.

Nga leximi i aktvdekjes për M. (T) S. me numër 200-392 lëshuar me datën 17.07.2014 nga Komuna e Prizrenit, gjykata ka vërtetuar se pas vdekjes të M. (T) S. tani ish nga fshati Vrbiqane, Komuna e Prizrenit, si pasardhës ka lënë, bashkëshorten L.S. dhe djalin Z.S.

Në raportin e ekspertit gjeodezisë K.G. i datës 05.10.2015, ndër të tjera konstatohet se me rastin e daljes në vendin e ngjarjes është bërë identifikimi i ngastrave kadastrale nr.232, 234 dhe 236 në vendin e quajtur “Qepurec nën rrugë” të gjitha ZK Arbanë (Dushanovë), si dhe ngastrat kadastrale 232, 234 dhe 236 ZK Dushanovë shfrytëzohen me kulturë kullosë (të papunuara) dhe në këto ngastra nuk ka të ndërtuara kurrëfarë objekte si dhe nuk ka të mbjellura kultura shumvjeqare. Poashtu me identifikimin në vende dhe përshkrimin e kufitarëve nga kontrata shitblerje Leg.nr.680/59 e datës 10.08.1959 ku objekt i shitblerjes është ngastrat kadastrale nr.II/76 në ZK Dushanovë në vendin e quajtur “Qepurac” me kulturë arë në sipërfaqe prej 5900m2 dhe vreshtë në sipërfaqe prej 600 m2 e në sipërfaqe të përgjithshme prej 6500 m2. Po ashtu nga shiqimi në kopjen e skicës së matjeve detale të vitit 1954 Nr.8/54 ngastra nr.II/76 sipas kadastrit përshkruet konstatohet se i përgjigjet në tërësi ngastrave kad.232 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë arë e kl. (5) në sipërfaqe prej 471 m2 dhe vreshtë i kl. (2) në sipërfaqe prej 461 m2 e në sipërfaqe prej 932 m2, ngastra nr.234 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë arë e kl.(5) në sipërfaqe prej 3577 m2 dhe ngastra nr.236 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë arë e kl.(5) në sipërfaqe prej 1923 m2 e në sipërfaqe të përgjithshme prej 6432 m2 sipas planeve kadastrale të matjeve detale të vitit 1954. Ngastra kadastrale nr.232 në sipërfaqe të përgjithshme prej 932 m2 është në kufijtë e vet sipas planeve kadastrale të matjeve detale të vitit 1954. Kjo ngastër në anën Lindore kufizohet në gjatësi prej 14.74 m, në anën perëndimore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 16.68 m, në anën Veriore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 59.62 m dhe në anën Jugore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 50.17 m. Po ashtu ngastra kadastrale nr.234 në sipërfaqe prej 3577 m2 është në kufijtë e vet sipas planeve kadastrale të matjeve detale të vitit 1954. Kjo ngastër në anën Lindore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 58.69 m, në anën Perëndimore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 37.36 m, në anën Veriore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 85.37.m dhe në anën Jugore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 74.62 m. Ngastrat kadastrale nr.236 në sipërfaqe prej 1923 m2 është në kufijtë e vet sipas planeve kadastrale të matjeve detale të vitit 1954. Kjo ngastër në anën Lindore kufizohet në gjatësi prej 51.66 m, në anën Perëndimore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 45.81 m, në anën Veriore kufizohet në gjatësi prej 30.66 m dhe në anën Jugore kufizohet në gjatësi të përgjithshme prej 31.50 m.

Po ashtu në seancën e datës 24.08.2023 eksperti gjyqësor K.G. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë ekspertizës me shkrim të datës 05.10.2015, si dhe për gjendjen e përshkruar deri më atë datë, ndërsa për gjendjen nga ajo datë duhet të bëjë identifikimin në vend për gjendjen faktike në teren dhe shiqimin në operatin kadastral për gjendjen e kadastrit.

Nga leximi i parashtresës të datës 22.07.2014 gjykata ka konstatuar se, i autorizuari i paditësit avokat S.R. nga Prizreni, me parashtresën në fjalë i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës me të cilën e ka njoftuar mbi fillimin e procedurës kontestimore pranë gjykatës Themelore në Prizren me numrin Cnr.414/2013.

Nga leximi i raportit plotësues të datës 31.08.2023 me të cilin është zëvendësuar raporti i datës 05.10.2015 është konstatuar se, me daljen në vend dhe përshkrim e kufitarëve nga kontrata shitblerje Leg.nr.680/59 e datës 10.08.1959 ku objekt i shitblerjes është ngastra kadastrale nr.II/76 në ZK Dushanovë në vendin e quajtur “Qepurec” me kulturë arë në sipërfaqe prej 5900 m2 dhe vreshtë në sipërfaqe prej 600 m2, apo në sipërfaqe të përgjithshme prej 6500 m2. Po ashtu ka konstatuar se në shiqimin në kopjen e skicës së matjeve detale të vitit 1954 Nr.7/54

ngastra nr. II/76 sipas kadastrit përshkrues konstatohet se i përgjigjet në tërësi ngastrave kad.232-0 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë arë e kl. (5) në sipërfaqe prej 471 m² dhe vreshtë i kl. (2) në sipërfaqe prej 461 m² e në sipërfaqe prej 932 m², ngastra nr.234-0 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë Jopjellore- lum në sipërfaqe prej 150 m² dhe arë e kl. (5) në sipërfaqe prej 3577 m² e në sipërfaqe të përgjithshme 3727 m² dhe ngastra kadastrale nr.236 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë arë e kl. (5) në sipërfaqe prej 1923 m² e në sipërfaqe të përgjithshme prej 6582 m² sipas planeve kadastrale të matjeve detale të vitit 1954. Po ashtu ngastra kadastrale nr.232 në vendin e quajtur “Qepurec-nën rrugë” me kulturë arë e kl. (5) në sipërfaqe prej 471 m² dhe vreshtë i kl.(2) në sipërfaqe prej 461 m² e në sipërfaqe të përgjithshme prej 932 m², ngastra kadastrale nr.234 në vendin e quajtur “Qepurec- nën rrugë” me kulturë Jopjellore- lum në sipërfaqe prej 3577 m² e në sipërfaqe të përgjithshme prej 3727 m² dhe ngastra kadastrale nr.236 në vendin e quajtur “Qepurec-nën rrugë” me kulturë arë e kl. (5) në sipërfaqe prej 1923 m² evidentohen në fletë posedimin nr.251 ZK Dushanovë në emër të Pasurisë Shoqërore e KK Prizren.

Në seancën e datës 12.10.2023 eksperti i gjeodezisë K.G. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë raportit plotësues të datës 31.08.2023, skicat e terrenit dhe komplet pronës.

Baza ligjore

Në bazë të nenit 111 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në mënyrë decisive është paraparë se **“kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është e caktuar me këtë ligj ose dispozitë të veçantë”**. Ndërsa me nenin 117 të po këtij ligji parashihet se **“e drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës. Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 vitesh nga data e lidhjes së kontratës”**.

Duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqjese dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, e njëjta duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Kjo ngase siq edhe u cek më lartë, me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar qartë se kur gjatë lidhjes së kontratës përkatëse, ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve (kërcënim, lajthim, dhunë etj), në të cilat është thirrur pala paditëse, atëherë kemi të bëjmë me kontrata të rrëzueshme, e jo me kontrata absolutisht nule. Pra në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një kontratë të rrëzueshme. E drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës. Kjo e drejtë, në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 (tre) vitesh nga data e lidhjes së kontratës. Afati në fjalë është afat prekluziv. Në bazë të provave të administruara në këtë çështje kontestimore, del se kontrata mbi dhuratën br.Posl.ov.br.680-59, anulimi i të cilës kërkohet është lidhur me datë 10.09.1959, ndërsa padia e paditësit për anulimin e kësaj kontrate është parashtruar pranë kësaj gjykate me datë 20.05.2013 që i bie dikund pas 54 vitesh. Bazuar në të lartëcekurat, gjykata vlerëson se nuk mund të kërkohet anulimi i kontratës përkatëse të rrëzueshme, siç është rasti në fjalë, pas afatit prekluziv 3 vjeçar, andaj edhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të gjitha provave të administruara, gjykata konstaton se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar ekzistimi i kërcënimit apo dhunës. Edhe po të ekzistonte kërcënim, lajthimi

apo mashtrimi, sipas vlerësimit të gjykatës, i njëjti nuk ka qenë i natyrës së tillë që të mund të krijonte rrezikshmëri serioze për jetën, trupin ose ndonjë vlerë të rëndësishme për palën kontraktuese apo anëtarët e familjes së tij, si dhe për të njejtat kërcënime ka mundur të kërkohet mbrojtja juridike pranë organeve kompetente në procedurë të përcaktuar ligjore. Poashtu, edhe po të supozohet se ka pasur mungesë të shprehjes së vullnetit për shkak të kërcënimit, lajthimit apo mashtrimit, sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile, kjo kontratë do të ishte relativisht e pavlefshme, dhe nuliteti i kontratës për arsye të tilla do të mund të kërkohet në afat prej 1 (një) viti, respektivisht e drejta e tillë do të humbte me kalimin e afatit prej 3 (tre) vjetësh.

Dëshmisë së dëshmitarëve T.Sh. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit dhe B.Dž. nga fshati Skorobishtë, Komuna e Prizrenit, gjykata nuk ia fali besimin, pasi që për gjykatën nuk ka qenë bindëse, pasi që nuk kanë sqaruar se nga ana e kujt është bërë presioni apo dhuna, dhe ka qenë në kundërshtim me provat e tjera të administruara. Në bazë të lartë cekurave gjykata është e mendimit se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar, respektivisht se nuk ka kushte ligjore për anulimin e kontratës Posl.ov.br.680-59 të datës 10.09.1959, e as për fitimin e të drejtës së pronësisë dhe dorëzimit të paluajtshmërisë në posedim të paditësit.

Nga arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, kjo gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, pasi që asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.414/13 të datës 12.10.2023

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.